

TEKSTI I FAQES WEB FESTA E SHKOLLAVE 2017

Festa e shkollave të ciklit të 1-rë (1P-4P) – e mërkurë, 28 qershor 2017

INFORMACIONE FAMILJE/PRINDËR

Përpara festës

Në mes të qershorit, prindërit që kanë fëmijë të ciklit fillor (1P-4P) në një shkollë fillore të qytetit, marrin një fletëpalosje informacioni mbi festat. Për t'u shkarkuar këtu.

Në këtë broshurë, mësuesit/-et shënojnë orën në të cilën ju duhet të sillni fëmijën/-ët tuaj në shkollën e tij/saj. Lutemi të jeni të përpiktë, sepse autobusët duhet të nisen në mënyrë shumë të saktë drejt vendit të festës.

Fëmijët nuk duhet të sillen në mënyrë të drejtpërdrejtë në Parkun e Bastions ose gjatë nisjes së kortezhit.

Dita e festës

Kushtet meteorologjike

Në rast dyshimi për kohën, vendimi për të organizuar ose jo kortezhin dhe/ose festën në park merret nga Këshilli i Administrimit të mërkurën në mëngjes.

Ky informacion mundësohet në numrin **1600**, duke nisur nga ora 12.00.

Në rast moti të pasigurt, organizohet vetëm festa në park.

Transportet publike sjellin fëmijët, siç është parashikuar, por i lënë direkt në parkun e Bastions.

Në rast moti shumë të keq, kortezhi dhe festa në park anulohen.

Nxënësit dhe mësuesit kthehen në shkollën e tyre (nëse nuk janë tashmë atje) në orën 13.30. Nxënësit lirohen në orën 16.00.

Kortezhi

Për çështje të organizimit dhe të sigurisë, vendi i nisjes së kortezhit, sheshi/esplanade St Antoine, nuk është i hapur për publikun ose për familjen.

Mbi 6.000 fëmijë marrin pjesë në këtë kortezh. Lutemi respektoni udhëzimet. Ju mund të ndiqni kortezhin në mënyrë të drejtpërdrejtë në Léman Bleu dhe festën në Bastions. Ky reportazh do të ritransmetohet gjithashtu disa herë gjatë gjithë verës.

Itinerari i kortezhit

Promenade Saint-Antoine → Rue des Chaudronniers → Place du Bourg-de-Four → Rue Verdaine → Rue de Rive → Rue de la Croix-d'Or → Rue du Marché → Rue de la Confédération → Rue de la Corraterie → Place de Neuve

Parku i Bastions

Parku është i hapur dhe në të mund të hyhet në orën 17.30 dhe karuselet janë në dispozicion pa pagesë deri në orën 19.00.

Fëmijët presin prindërit e tyre pranë tavolinave të shkollës së tyre. Shkollat janë të organizuara me grupe (shikoni planin bashkëngjitur).

Numrat e grupeve janë të afishuara.

Me qëllim që hyrja në park të jetë e lirshme, lutemi respektoni udhëzimet e mëposhtme:

- **Shkollat që i përkasin grupeve 1 dhe 2 > lutemi prisni fëmijët tuaj nga ana e rrugës/rue Saint-Léger**
- **Shkollat që i përkasin grupeve 3, 4, 5, 6, 7 ,8 > lutemi prisni fëmijët tuaj nga ana e Place de Neuve**

Në ekranet tuaj

I gjithë manifestimi do të ritransmetohet në mënyrë të drejtpërdrejtë në r Léman Bleu dhe në ekranin e madh të instaluar në hyrje të parkut të Bastions.

Informacione shtesë

Shërbimi i shkollave dhe institucioneve për fëmijët
022.418.48.38

Festë e shkollave të ciklit të 2-të (5P-8P) – E premte, datë 30 qershor 2017

INFORMACIONE PËR FAMILJARËT/PRINDËRIT

Përpara festës

Në mes të qershorit, prindërit që kanë fëmijë në ciklin fillor (5P-8P), në shkollën fillore të qytetit, marrin një fletëpalosje informative mbi festat me një «pije të mirë» pa alkool që i ofrohet të gjithë nxënësve, e vlefshme pranë standave të shoqatave, të prezantuara në parkun e Bastions prej orës 17.00 deri në orën 22.30.

Dita e festës

Kushtet meteorologjike

Manifestimi do të zhvillohet në varësi të motit.

Parku i Bastions

17.00: Hapja e festimeve

Argëtime, lojra, spektakle dhe shëtitje/vend ku pihet ujë/restorant/muzikë.

Fëmijët shkojnë direkt atje, nën drejtimin e prindërve të tyre dhe nën përgjegjësinë e tyre të plotë. Të gjithë fëmijët kanë akses të lirë dhe pa pagesë në të gjitha zbavitjet.

22.00: Spektakël i zërit dhe dritës përpara Pallatit Eynard

Një spektakël zanash i shfaqur për herë të parë në Gjenevë.

22.30: Mbyllja e festimeve

AKSES TPG

Tram 12

Autobus 3, 5, 36

Stacioni: Place de neuve

Informacione shtesë:

Shërbimi i shkollave dhe institucioneve për fëmijët

022.418.48.38

Ceremonia e klasave 8P – E premte, datë 30 qershor 2017 – Victoria Hall

INFORMACIONE PËR FAMILJARËT DHE PRINDËRIT

Ceremonia e klasave 8P do të zhvillohet në orarin shkollor prej orës 15.30 deri në orën 16.30

Prej orës 15.30 deri në orën 16.30, Victoria Hall do të mirëpresë nxënësit e klasës 8P dhe mësuesin/-en e tyre për një ceremoni dedikuar nxënësve që përfundojnë shkollimin e tyre fillor.

Është një etapë e rëndësishme në jetën e një nxënësi: kalimi nga bota e fëmijërisë në adoleshencë, me sfidat e saj të shumta.

Për të shënuar këtë kalim, Qyteti i Gjenevës organizon një eveniment zyrtar të rezervuar për nxënësit dhe mësuesit/-et e tyre.

Ceremonia nuk është e hapur për prindërit, por është realizuar një video prej Léman Bleu dhe ju mund ta shikoni atë në ditët që vijojnë në faqen e kanalit.

Prej orës 16.30 deri në orën 17.00

Në fund të ceremonisë, nxënësit grupohen sipas klasës për të shkuar deri në parkun e Bastions, të shoqëruar prej mësuesit/-es/-ve, agjentëve të policisë bashkiake, rojeve të shkollës dhe personelit të shërbimit të shkollave.

Që prej atij momenti, ata mund të përfitojnë prej animimeve të realizuara për festën e ciklit të 2-të përpara hapjes.

Prej orës 17.00

Nxënësit nuk do të jenë më nën përgjegjësinë e mësuesit/-es/-ve të tyre. Prindërit duhet të bashkohen me fëmijën/-t e tyre në atë vend. Me qëllim lehtësimin e pikave të tyre të takimit, tabelat me emërat e shkollave të ciklit të 2-të janë vendosur pranë tavolinave. Një plan i vendndodhjes është vendosur në rrethimin e parkut nga ana e Place Neuve.

Prej orës 17.00 deri në orën 22.30: festa e shkollave të ciklit të 2-të

Argëtime, lojra, spektakle dhe shëtitje/vend për të pirë ujë/restorant/muzikë.

Fëmijët shkojnë direkt atje, nën drejtimin e prindërve të tyre dhe nën përgjegjësinë e tyre të plotë. Të gjithë fëmijët kanë akses të lirë dhe pa pagesë në të gjitha zbatimjet.

22.00: Spektakël i zërit dhe dritës përpara Pallatit Eynard

Një spektakël zanash i shfaqur për herë të parë në Gjenevë.

22.30: Mbyllja e festimeve

AKSES TPG

Tram 12

Autobus 3, 5, 36

Stacioni: Place de Neuve

Informacione shtesë:

Shërbimi i shkollave dhe institucioneve për fëmijët

022.418.48.38